

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.Zh., nga Gjakova, për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë në punë nga neni 186 par 5 lidhur me par 3 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.38/2017, të datës 28.04.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 03.07.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar, ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.38/2017, të datës 28.04.2017, **vërtetohet.**

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.38/2017, të datës 28.04.2017, i akuzuari L.Zh., për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë në punë nga neni 186 par 5 lidhur me par 3 të KPK, është liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë, Prokuroria Themelore në Gjakovë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i akuzuari, duke propozuar që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pa bazuar.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.694/2017, të datës 15.06.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, ka

propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të shpallet fajtor, ndërsa të refuzohet si i pa bazuar propozimi nga përgjigja në ankesë i të akuzuarit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, nuk është e bazuar.**

Me qenë se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë për kundër faktit se ka nxjerrë të gjitha provat për vërtetimin e fakteve, gabimisht ka vlerësuar përmbajtjen e tyre, dhe si pasojë e kësaj gabimisht ka vendosur kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza. Gjithashtu nga provat materiale, raporti i vendit të ngjarjes me foto-dokumentacion, raporti zyrtar i trupit ekzekutiv të inspektoratit të punës, është theksuar se punëdhënësi ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit për siguri në punë, dhe se në mënyrë të mjaftueshme vërtetohet se vepra penale është pasojë e mos ndërmarrjes së masave të duhura në punë si dhe nga mos menaxhimi i ambientit të punës nga i akuzuari, dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri te lëndimet e rënda trupore nga të cilat ka ardhur deri te vdekja e punëtorit në punë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e prokurorisë, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kjo për faktin se në asnjë provë nuk ka mundur të vërtetojë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Gjendja e tillë faktike është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve Z.P., A.K. dhe A.S., që të tre inspektorë të punës, të dhënë në shqyrtim gjyqësor, të cilët kanë deklaruar se deri te aksidenti me pasojë të vdekjes nuk ka ardhur nga pajisjet e punës së të akuzuarit L.Zh., por nga pajisjet e kontraktuesit-furnitorit NTSH. "N". Gjithashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga deklarata e inxhinierit të makinerisë A.K., i cili ka deklaruar se në bazë të rrethanave të ndodhjes së rastit ka patur tejkalim të normave të sigurisë nga transportuesi i pllakave të mermerit i cili ka bërë transportin e mallit me pajisje të tija të punës. Gjykata e shkallës së parë dëshmisë së këtyre dëshmitarëve iu ka falur besimin për faktin se dëshmitë e tyre janë në harmoni edhe me ekspertizën e ekspertit të inxhinierisë mekanike Naser Lajqi, nga e cila rezulton se deri te rrëshqitja e pllakave ka ardhur si rezultat i goditjeve të pllakave gjatë transportimit dhe ngarkimit të tyre, ku këndi i pjerrtësisë së pykës ka qenë shumë më e vogël se sa pjerrtësia e mjaftueshme për ti mbajtur pllakat e mbështetura për kontrizën "A", ku ka vazhduar rrëshqitja e pllakave, dhe se nga kjo vërtetohet se pasoja për vdekjen e të ndjerit H.Q., nuk është shkaktuar nga mos

ndërmarrja e masave të sigurisë në punë nga i akuzuari, por është shkaktuar nga mjetet e punës së kontraktorit të tij, gjegjësisht firmës NTSH “N”, për të cilat i akuzuari nuk ka patur për obligim që të sigurojë mjete të punës. Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se i dëmtuari-i ndjeri H.Q., si punëtor i kompanisë “M”, nuk ka patur për obligim e as urdhër nga këtu i akuzuari për shkarkimin e këtij malli, e cila vërtetohet nga deklarata e dëshmitarëve J.sH. dhe I.M.-punëtorë të kompanisë NTSH “N”, ngase këta të fundit kanë qenë të obliguar të bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e këtij malli, andaj, duke patur parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarin L.Zh., për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë në punë nga neni 186 par 5 lidhur me par 3 të KPK, e ka liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.673/2017 të datës 03.07.2017**

**Zyrtari Ligjor**  
**Visar Gashi**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Rasim Rasimi**